



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:052453

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05762831

P.nr.119/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjyquese Benita Berisha, me zyrtarin ligjor Besart Mustafa, në çështjen penale ndaj të akuzuarit F.Xh., për shkak të veprës penale: Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.103/23 të datës 28.02.2024, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar publik me datë 30.05.2024, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Ajtene Zoni dhe të akuzuarit F.Xh., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 31.05.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F.Xh., nga i ati M... dhe e ëma B..., e vajzërisë F..., i lindur me datë ..., në M..., me vendbanim në T..., rr. "Rr... S...", M..., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Me datën 26.10.2022 rreth orës 15:38 min në Mitrovicë në parkun e qytetit "Xh... dhe F.... Ll..." pa autorizim ka poseduar narkotik ,ashtu që pas një kontrolli sipërfaqësor nga hetuesit e DHTN-së, tek i pandehuri është gjetur një qese e vogël me substancë narkotike e llojit kanabis (marihuan), që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë neto e përgjithshme 0.78 ± 0.0001 gram.

Me këtë ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK –së.

Andaj, Gjykata në bazë të dispozitave të neneve: 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70 lidhur me nenin 269 par. 2 të KPRK-së, si dhe neneve: 364, 365, 449 dhe 452 të KPP-së, të akuzuarit, i:

SHQIPTON

- I. **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej 200 € (*dyqind euro*), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veproj konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t'ia zëvendësoj me dënim me burgim, duke llogaritur për çdo 20 (njëzet) euro gjobë me një (1) ditë burgim.
- II. Në bazë të nenit 269 par.3 të KPRK-së, konfiskohet një qese e vogël me substancë narkotike e llojit kanabis (marihuan), që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë neto e përgjithshme 0.78 ± 0.0001 gram. URDHËROHET Policia e Kosovës të bëjë shkatërrimin e saj sipas procedurave standarde ligjore në fuqi, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.
- III. Obligohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 30 €, ndërsa në emër të fondit të kompensimit të viktimave shumë prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm.
- IV. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.103/23 të datës 28.02.2023, kundër të akuzuarit F.Xh. për shkak të veprës penale: Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 30.05.2024, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Ajtene Zoni dhe i akuzuari F.Xh..

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, të akuzuarit i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë, ashtu që në këtë seancë i akuzuari lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se e pranon fajësinë në tërësi sipas aktakuzës, është penduar thellë për rastin që ka ndodhur dhe shpreh keqardhje, duke shtuar se më nuk është përdorues i substancave narkotike, i kërkoi falje gjykatës dhe i premtoi që në të ardhmen nuk do të përsëris më veprime të tilla.

Prokurori i Shtetit Ajtene Zoni lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ngase pranimi i fajësisë është dhënë në mënyrë vullnetare konform dispozitave ligjore të nenit 242 të KPP-së, pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Tutje ka deklaruar se, kërkon nga gjykata që të njëjtin ta shpall fajtor për veprën e kryer penale, t'i shqiptoj një sanksion penal me të cilin do arrihet qëllimi i dënimit, ashtu që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit si rrethanë lehtësuese të merret parasysh pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, ndërsa sa i përket rrethanave rënduese, shkallën e përgjegjësisë penale si dhe intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit e vlerës së mbrojtur.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i akuzuari, e në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, në këtë drejtim ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të akuzuarin.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në mënyrë vullnetare, se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, duke e njoftuar të akuzuarin se pas pranimin të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, nga këto arsye gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të akuzuarit dhe bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari F.Xh. ka kryer veprën penale: Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së, e për të cilën veprë është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së.

Gjykata, si rrethanë veçanërisht lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale nga i akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar, si rrethana lehtësuese gjeti keqardhjen e shprehur, pendimin e thellë për veprën e kryer, moshën e re të të akuzuarit, si dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërisë më veprime të tilla. Ndërsa, rrethana rënduese në rastin konkret nuk gjeti.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit. Po ashtu gjykata vlerëson se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 38 të KPRK-së, që të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin lidhur me konfiskimin, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata e mori konform nenit 269 par.3 të KPRK-së, ku përcaktohet se “ *Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge konfiskohen*”.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në kuptim të nenit 449 par.2 nën par.2.6 dhe nenit 452 par.1 të KPP-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën par 3.1 të Ligjit numër 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Kërkesë pasurore juridike nuk pati, ngase sipas aktakuzës nuk pati të propozuar palë të dëmtuar.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni penal
P.nr.119/2023, datë: 31.05.2024

Zyrtari Ligjor
Besart Mustafa

G j y q t a r j a
Benita Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate.